



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-076

Prishtinë, më 24 shtator 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 24 SHTATOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Enis Kervan dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Sasha Milosavleviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d t ë d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11 shtator 2012,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 11 shtator 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 11 shtator 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi diskutoi për pikat e propozuara, vendosi që Kuvendi gjatë javës së parë të tetorit t'i mbajë dy mbledhje plenare.

Mbledhja plenare, më 3 tetor 2012, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d t ë d i t ë s

1. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë.

Mbledhja plenare, më 4 tetor 2012, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d t ë d i t ë s

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i Raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011,

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e funksionarëve publikë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti,
9. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011,
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
11. Shqyrtimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës,
12. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës,
13. Interpelanca e ministrit Enver Hoxhaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Kryesia këtë pikë të rendit të ditës e radhiti për shqyrtim në mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 4 tetor 2012.

2. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e deputetit Visar Ymeri, për të debatuar në Kuvend për procesin e privatizimit në Kosovë, me shumicë votash, vendosi që për këtë pikë të debatohet në mbledhjen plenare, më 3 tetor 2012.

3. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, mbështetur edhe nga shtatë deputetë të tjerë, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës

Kryesia kërkesën e lartshënuar e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare më 4 tetor 2012.

4. Interpelanca e ministrit Enver Hoxhaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës

Kryesia kërkesën e lartshënuar për interpelancë e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare më 4 tetor 2012.

5. Rekomandimi i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për miratimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës

Kryesia rekomandimin e lartshënuar e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare më 4 tetor 2012.

6. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar të katër deputetëve në Gjermani

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Arben Gashi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu dhe Amir Ahmeti, që të marrin pjesë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare të Komisioneve Parlamentare për Çështje Ligjore, që do të mbahet në Gjermani, prej 2-4 tetor 2012.

2. Shpenzimet e akomodimit për të lartshënuarit në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori - Fondacioni për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (IRZ), ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

7. Kërkesa për lejimin e udhëtimit të deputetit Lutfi Haziri në Mal të Zi

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri në Mal të Zi, prej 4-7 tetor 2012.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të lartshënuarin në paragrafin një (1) të këtij vendimi përballohen nga buxheti i Kuvendit.

8. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për vizitën e zotit e Eric Metaxas në Kuvendin e Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit dhe shpenzimet tjera që dalin me rastin e vizitës të zotit Eric Metaxas dhe delegacionin që e udhëheq ai, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 18 dhe 19 tetor 2012.

9. Kërkesa për lejimin e vizitës zyrtare të dy nënkryetarëve të Kuvendit në Mal të Zi

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i nënkryetarëve të Kuvendit: Xhavit Haliti dhe Petar Miletqi, si dhe i stafit të Administratës së Kuvendit: Shaban Selimi, Tringa Lila, Fadil Sfishta dhe Milosh Todoroviq që të marrin pjesë në seminarin e 81-të të Rose-Roth, me temën “Vendosja e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor - Përmbushja e premtimit të integritetit Euro-Atlantik”, të organizuar nga Asambleja Parlamentare e NATO-s, që do të mbahet në Shën Stefan të Malit të Zi, më 14-18 tetor 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit për të lartshënuarit në paragrafin një (1) të këtij vendimi përballohen nga buxheti i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*